



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 181, datë 13.12.2011

**PËR
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT SHOQËRISË “CREDINS BANK” SH.A PËR TË
VEPRUAR SI KUJDESTAR I OBLIGACIONEVE TË SHOQËRIVE
AKSIONARE DHE TË QEVERISË VENDORE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 11, të Ligjit nr 10158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” dhe Rregullores nr. 124, datë 7.12.2010 “Mbi afatet, kushtet dhe procedurat për autorizim të bankave si kujdestarë të obligacioneve”, me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Autorizimin e shoqërisë “Credins Bank” sh.a për të vepruar si kujdestar i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**